

PËRNGJASHMIMI GJUHËSOR NË MES TË GJAKOVËS DHE SHKODRËS

Sindorela Doli-Kryeziu

Adr."Isa Grezda", nr. 6, Gjakovë ,Kosova. Email: sindidol@yahoo.com

Abstrakti

Duke pasur parasysh këtë studim përqasës që do të bëhet mbi ngulitjen e standardit në dy zonat e parapara në këtë projekt, në Gjakovë dhe Shkodër, do të bëhen aktivitete hulumtuese se si ka ndikuar sistemi politik, kushtet ekonomike, edukimi shkollor në këto dy zona që janë shumë afër njëra-tjetrës. Ky do të jetë një studim pararendës që do ta plotësonte më së miri temën e doktoratës "Shtrirja e shqipes standarde në Gjakovë". Shtrohet pyetja pse pikërisht në Shkodër?. Arsyeja është që gjithmonë është thënë që Gjakova dhe Shkodra kanë ngjajshmëri kulturore, historike dhe gjuhësore. I përkasin të njëjtit dialekt verior, kanë të njëjtat karakteristika fonetike, morfologjike dhe leksikore, por me ndonjë nuancë dallimi jo shumë të dukshëm. Prandaj, duke u munduar të analizojmë dallimet dhe ngjajshmëritë dialektore e sidomos pas ngulitjes së standardit dhe ndikimet e faktorëve që i përmendëm më sipër, do të paraqesim përmes pyetësoreve që do t'i nënshtrohen gjakovarët dhe shkodranët, gjithmonë sipas metodës deduktive nga e përgjithshmja në të vecantën. Metoda mbizotëruese do të jetë ajo e hulumtimit dhe interpretimit, ndërsa një vend me rëndësi në trajtimin e kësaj teme do të zërë edhe metoda e anketimit/pyetësorit rreth shtrirjes së gjuhës standarde në Gjakovë dhe Shkodër. Do të bëjmë krahasimin e situatës që pretendojmë ta shtjellojmë në shqipen, pak a shumë dallimet edhe me situatat në gjuhët e tjera, të cilat kanë traditë më të gjatë të gjuhës standarde, si dhe të vendeve që kanë situata të përafërta zhvillimore të standardit, me atë të shqipes.

Fjalët kyce: *Gjakova, Shkodra, ngjajshmëritë, standardi, faktorët e ndryshëm, edukimi.*